


**Dokument Politikash:**

**Akresi i Rinisë në Sistemin Politik**

**Rasti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike**



Autorët: Prof. Assoc. Dr. Nevila Xhindi dhe MSc. Brenton Kotorri

*Autorët e prodhuan këtë dokument për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci.*

**NENTOR 2020**

## ***Mirënjohje***

*Autorët shprehin mirënjohjen e tyre për kryesinë dhe përfaqësuesit e Forumit Rinor të Partisë Demokratike (FRPD), të cilët iu përgjigjën menjëherë kërkesës sonë dhe morën pjesë në këtë studim duke ofruar njohuritë e tyre mbi zhvillimet aktuale të FRPD dhe perspektivat në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë.*

*Do të donim që t'i përçonim falenderimet tona anëtarëve të FRPD që morën pjesë në fokus-grupet e organizuara, dhe na mundësuan informacione të vyer mbi analizën dhe rekomandimet.*

*Së fundmi, falenderime të veçanta për ekipin e Westminster Foundation for Democracy në Tiranë për mbështetjen dhe inkurajimin.*

## Lista e shkurtimeve

BE	-	Bashkimi European
DEMYC-		Democrat Youth Community of Europe
EQL	-	Europa Qendrore Lindore
EDS	-	European Democrat Students
EPP	-	European People's Party
FRPD	-	Forumi Rinor i Partisë Demokratike
GRUD	-	Grupimi Rinor Universitar Demokrat
IPU	-	Inter-Parliamentary Union
IYDU	-	International Young Democrat Union
JOVP	-	Jugendorganisation Österreichs
JU	-	Junge Union
KAS	-	Konrad Adenauer Stiftung
KQZ	-	Komisioni Qendror Zgjedhor
KOP	-	Komiteti i Orientimit të Politikave
LGD	-	Lidhja e Gruas Demokrate
PD(Sh)	-	Partia Demokratike (e Shqipërisë)
TIK	-	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
YEPP	-	Youth European People's Party

## Abstrakt

Vala e interesimit e kohëve të fundit mbi pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, veçanërisht në nivel ndërkombëtar, jep shpresë për një rihapje të debateve dhe propozimeve mbi theksimin e rëndësisë për përfshirjen e të rinjve dhe pikëpamjeve të tyre në proceset politike.

Problemet që lidhen me angazhimin politik të të rinjve në Shqipëri, nuk kanë tërhequr aq sa duhet vëmendjen e politikëbërësve. Të rinjtë e sotëm meritojnë mundësi reale për të marrë pjesë në proceset politike, me qëllim dhënien e zgjidhjeve praktike të cilat çojnë përpara zhvillimin. Kur të rinjtë kanë mundësinë të organizohen, t'i japin zë mendimit të tyre dhe të luajnë një rol domethënës në vendimmarrje, ata tregojnë vullnetin dhe aftësitë e duhura për të çuar përpara një ndryshim të qëndrueshëm pozitiv. Ata gjithashtu janë më të prirur për të kërkuar demokraci dhe për ta mbrojtur atë duke fituar një ndjenjë më të madhe përkatësie.

Ky studim fokusohet tek përfshirja politike e të rinjve në Partinë Demokratike të Shqipërisë. Si është parë përfshirja e të rinjve dhe cilat modele janë krijuar? Si lidhet pjesëmarrja e të rinjve me vizione të ndryshme për demokracinë? Studimi përfshin gjithashtu edhe disa komente se si mund të përmirësohet përfshirja dhe promovimi i të rinjve në Partinë Demokratike të Shqipërisë.

Studimi analizon Forumin Rinor të Partisë Demokratike të Shqipërisë nën lanten e përfshirjes së të rinjve, përfaqësimit politik rinor nga zgjedhjet qendrore tek ato lokale, aspekte të vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes, demokracia e brendshme dhe organizimi, financimi dhe transparencja, pjesëmarrja në platforma rinore ndërkombëtare, impakti i Covid-19 dhe rinia; si dhe ide dhe sugjerime për PD se si të adresojë problematikat rinore në programin e vet elektoral për zgjedhjet e përgjithshme të 2021.

Ky studim thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve me qëllim nxitjen e qytetarisë aktive tek të rinjtë, thekson integrimin dhe përfshirjen e tyre dhe forcon kontributin e tyre në zhvillimin e demokracisë shqiptare. Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendime dhe veprime në nivel lokal dhe kombëtar është thelbësore për ndërtimin e një shoqërie më demokratike më përfshirëse dhe më prosperuese. Përfshirja politike e të rinjve shkon më larg sesa votimi apo kandidimi, megjithëse këto janë elemente po aq të rëndësishme sa edhe kontributi në vendimmarrje. Përfshirja nuk do të thotë thjeshtë të kesh të drejtën për pjesëmarrje por sidomos të pasurit e hapësirave, mundësive dhe mjeteve në dispozicion, dhe aty ku është nevoja edhe mbështetje me pjesëmarrje dhe vendime si dhe angazhimi në veprime dhe aktivitete që kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie shqiptare të përmirësuar.

Të rinjtë e sotëm në Shqipëri meritojnë mundësi reale për të marrë pjesë në procese politike dhe për të kontribuar në zgjidhje praktike që çojnë përpara zhvillimin.

Demonstrimet e viteve të fundit të studentëve me protesta, mund të shihen edhe si përgjigje ndaj sistemit politik për të cilin ndjejnë se nuk u jep pjesën e duhur të pushtetit dhe qytetarisë. Të rinjtë po gjejnë mënyra të tjera për ta ngritur zërin. Pjesëmarrja është një element thelbësor i qytetarisë në një shoqëri dhe vend demokratik.

<b>Përmbajtja</b>	
<b>1. Hyrje</b> .....	9
<b>1. Përshkrimi i problematikës</b> .....	12
<b>Përse duhen përfshirë të rinjtë në jetën politike?</b> .....	12
<b>Gjendja aktuale në FRPD</b> .....	13
<b>2. Opsionet për politika</b> .....	14
<b>Performanca e demokracisë së brendshme në FRPD</b> .....	14
<b>Transparenca financiare dhe llogaridhënia në FRPD</b> .....	16
<b>Edukimi për qytetari aktive</b> .....	17
<b>Pjesëmarrja e FRPD në platformat rinore politike europiane</b> .....	18
<b>Përfaqësimi rinor në organin më të lartë vendimmarrës në PD</b> .....	18
<b>4. Përfundime dhe rekomandime</b> .....	33
<b>Përfundime</b> .....	33
<b>Rekomandimet</b> .....	35
<b>Lista e referencave dhe burimeve</b> .....	36

Tabela 1. Organizimi i FRPD .....	14
Tabela 2. Përfaqësimi i të rinjve sipas statutit të PD.....	19
Tabela 3. Përqindja e kandidatëve të rinj në listën e PD për zgjedhjet parlamentare .....	20
Tabela 4. Përqindja e vendeve të të rinjve të PD në parlament.....	21
Tabela 5. Në shifra, përfaqësimi i të rinjve në këshillat bashkiakë: Zgjedhjet lokale 2011 dhe 2015 .....	23
Tabela 6.Fushat prioritare të të rinjve për zgjedhjet kombëtare 2021.....	25



## 1. Hyrje

Të rinjtë në Shqipëri luajtën një rol shumë të rëndësishëm në ndryshimin e sistemit politik nga një sistem monopartiak në një demokraci pluraliste. PD u krijua në dhjetor 1990 nga lëvizja studentore antikomuniste dhe ishte partia e parë politike e opozitës në Shqipëri në atë kohë me mbështetjen e gjerë të qytetarëve<sup>1</sup>. Sidoqoftë, në dekadën e fundit, përqendrimi i vëmendjes tek të rinjtë lidhej kryesisht me problemet me të cilat përballeshin të rinjtë në një sistem demokratik, siç janë papunësia, pabarazia, përjashtimi social, migrimi, varësia, etj.

Sipas statistikave rinia (mosha 19- 34 vjeç), përbën 29.4% të popullsisë së Shqipërisë<sup>2</sup>. Prej tyre afërsisht, një e treta është në shkollë dhe universitete, një e treta është e punësuar, dhe një e treta as nuk është në shkollë dhe as e punësuar<sup>3</sup>. Midis viteve 2014-2020, numri i popullsisë migruese neto është regjistruar në minus 104.872<sup>4</sup>. Vetëm gjatë vitit të kaluar, tendenca e migrimit u rrit me 13,3%<sup>5</sup>.

Pavarësisht përfaqësimit të lartë krahasuar me të gjithë popullsinë, gjendja e pjesëmarrjes së të rinjve në fushat ekonomike, sociale dhe politike, mbetet e ulët në të gjitha nivelet. Pra, pavarësisht se në tre vitet e fundit, 45.6% e Forcës së Punës është e përbërë nga të rinj, duke i shndërruar të rinjtë në forcën kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, 25.9% e të rinjve është e papunë dhe 15% e saj konsiderohet në rrezik të varfërisë . Ekzistojnë dallime të konsiderueshme nga mjediset rurale në ato urbane në lidhje me infrastrukturën, qasjen në shërbime dhe të ardhurat. Rreth 29.7% e të rinjve nuk janë as në punësim, arsim ose trajnim (INSTAT, 2017). Në qershor 2018, 48.3% e njerëzve në burgje ishin të rinj. Këto të dhëna janë rritur vetëm në 3 vitet e fundit me 11.7%. Në të njëjtën periudhë, numri i të rinjve të regjistruar në arsimin e lartë është një rënie me 5.5%, megjithëse nuk ka ende ndonjë korrelacion të provuar midis këtyre dy të dhënave.

Një studim i fundit i WFD (2019), tregon se të rinjtë shqiptarë janë të distancuar nga partitë politike, ku shumica dërrmuese (80%) nuk janë as të angazhuar si anëtarë politikë dhe as aktivistë. Disa, 10.8% janë anëtarë, dhe vetëm 9.2% janë aktivistë të partive politike (WFD, 2019: 9).

Në qershor 2018, qeveria më në fund ra dakord të fillojë të punojë për çështje që lidhen me të rinjtë. Gjëja e parë që ata bënë ishte krijimi i një grupi pune. Sidoqoftë, asnjë i ri ose organizatë rinore nuk ishin përfshirë.

<sup>1</sup> Nga 343 persona që nënshkruan aktin themelues të PDSH-së, 30% ishin studentë.

<sup>2</sup> INSTAT. Treguesit Demografikë dhe Socialë. Popullsia. <http://ëëë.instat.gov.al/media/5156/t1.xlsx>

<sup>3</sup> INSTAT. Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T2 – 2020. <http://ëëë.instat.gov.al/media/7429/atfp-t2-2020.pdf>

<sup>4</sup> INSTAT. Migracioni dhe integrimi i migrantëve. <http://ëëë.instat.gov.al/media/7273/t5.xlsx>

<sup>5</sup> INSTAT. Popullsia 1 janar 2020 fq.3. [http://ëëë.instat.gov.al/media/6849/popullsia\\_me-1\\_janar\\_2020.pdf](http://ëëë.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf)

Pandemia e COVID-19 i ka përmbysur jetët tona në çdo kuptim të mundshëm. Në momentin që shoqëritë tona kishin më shumë nevojë, anëtarët e forumit rinor kanë ofruar ndihmë për komunitetet përreth tyre. Ndërsa Shqipëria ngadalë do të shërohet nga vala e virusit dhe do të vendosë për një plan rikuperimi, pjesëmarrja domethënëse e të rinjve është thelbësore për çdo debat serioz të politikave publike. Pandemia ka prekur papritmas të gjitha aspektet e jetës sonë, rreziqet e diskutimit publik janë veçanërisht të larta. Pjesëmarrja e të rinjve në këtë debat nuk duhet të jetë vetëm një truk PR-i nga qeveritë, por mundësitë për pjesëmarrje duhet të jenë të mirëfillta dhe me cilësi të lartë.

Ky dokument politikash fokusohet tek:

- a) Analiza e gjendjes aktuale të përfshirjes së të rinjve të FRPD në vendimmarrjen e brendshme dhe kryesinë e PD, në nivelin lokal dhe qendror.
- b) Vlerësimi i angazhimit të të rinjve në PD dhe lloji i pjesëmarrjes politike të të rinjve, si konvencional, ashtu edhe jo konvencional, duke marrë parasysh ndryshimet në zonat e urbanizuara dhe ato periferike.
- c) Eksplorimi i tematikave / çështjeve kryesore të të rinjve që PD duhet të trajtojë në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 (p.sh. arsimit, punësimi, migrimi, përfshirja sociale, etj.)

Një hap paraprak i rëndësishëm ishte studimi i intervistave të thelluara cilësore dhe diskutimeve në fokus grupe me anëtarë të FRPD për të shqyrtuar se si kuptohet dhe përjetohet pjesëmarrja në politikë. 26 të rinj i ndanë mendimet e tyre me studiuesit. Komente të ngjyrosura dhe disa kritike dhanë ata persona të cilët kanë qenë ose janë politikisht aktivë çka u mundësoi studiuesve që të kuptonin më mirë frustrimin e të rinjve nga politika.

Ky dokument politikash synon kah vendimmarrësve dhe liderëve të rinj në PD, duke pasur si rast studimor FRPD-në dhe nuk kërkon të përgjithësojë gjetjet e veta përtej rrethit të studiuar.

Autorët janë të vetëdijshëm për disa kufizime të këtij dokumenti politikash duke pasur parasysh vështirësitë në mbledhjen e të dhënave dhe statistikave, mungesës së tyre, si dhe kampionit të pyetësorit të zhvilluar online.

Ky studim përfaqëson përpjekjen e parë për të analizuar pjesëmarrjen e të rinjve në PD dhe politikë, nga këndvështrimi i të rinjve.

Teksa zgjedhjet parlamentare kombëtare po afrohen, më 25 prill 2021, lejimi i të rinjve që të marrin në dorë axhendën e debatit publik, teksha shoqëria jonë përpiqet të ngrejë struktura të qëndrueshme sociale dhe

ekonomike, do të ishte dhe shansi i parë për vendimmarrësit politikë që të tregojnë se ata janë të gatshëm që jo vetëm t'i dëgjojnë por edhe të mësojnë prej të rinjve.

Përmes këtyre lenteve kemi analizuar përfshirjen e anëtarëve të FRPD në proceset politike të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PDSH), një sfidë komplekse dhe shumë dimensionale që duhet të adresohet me një larmi mjetesh, në varësi të objektivave dhe kontekstit të partisë. Nëse të rinjtë kanë perceptimin se proceset zyrtare politike nuk janë të arritshme dhe / ose tërheqëse për ta, kjo mund të formojë qëndrimet e tyre për tërë jetën, me ndikime të mundshme afatgjata negative në kulturën politike të PD.

## 1. Përshkrimi i problematikës

### Përse duhen përfshirë të rinjtë në jetën politike?

Pjesëmarrja politike nga të rinjtë është shfaqur vitet e fundit si një fokus thelbësor i përpjekjeve për të rritur demokracinë në të gjithë botën. Kjo vëmendje buron nga dy tendenca që në shikim të parë, shfaqen, në konflikt me njëra-tjetrën. Shqetësimi i parë ka të bëjë me "apatinë politike" midis të rinjve, i matur kryesisht në terma të pjesëmarrjes së ulët të votuesve. E dyta është rritja e njohjes së rolit qendror të luajtur nga të rinjtë në lëvizjet për demokraci në të gjithë globin. Së bashku, këto prirje kanë frymëzuar partitë politike për të filluar një program të ri për të identifikuar dhe trajnuar aktivistët e rinj për t'u bërë udhëheqës politikë. (Bacalso, 2019)

Pjesëmarrja e të rinjve i referohet gjerësisht pjesëmarrjes në një aktivitet, një proces, të një komuniteti ose një ekosistemi. Ndonjëherë pjesëmarrja i referohet vetëm pjesëmarrjes në një proces vendimmarrës dhe të kesh përgjegjësi, pushtet dhe një rol të njohur në ndikimin e komuniteteve lokale. Pjesëmarrja mund t'i referohet një procesi ku rinia mund të angazhohet dhe të ndikojë. Ai gjithashtu mund t'i referohet një rezultati, ku të rinjtë të kenë një shans për të kontribuar në një proces. (Ampe, 2012). Veçanërisht për rininë, pjesëmarrja është një parim i rëndësishëm.

Situata ekonomike dhe sociale botërore e krijuar nga pandemia Covid-19, demonstroi se të rinjtë po kërkojnë një ndryshim se kush ka pushtetin, dhe në mënyrën se si përdoret ky pushtet, megjithatë të rinjtë ende e gjejnë veten të marginalizuar nga politika zyrtare dhe janë të kufizuar për të ushtruar të njëjtin ndikim mbi proceset e vendimmarrjes (Agnieszka Kazimierczuk dhe Hannah Itcovitz, 2020).

Problemet në lidhje me angazhimin politik të të rinjve jo gjithmonë marrin vëmendjen e duhur nga politikbërja. Të rinjtë shpesh përfshihen në shoqërinë civile si një veprim paraprak drejt politikës dhe vendimmarrjes. Përfshirja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes shpesh pengohet nga mendësia e vjetër e disa anëtarëve të partisë, të cilët i konsiderojnë të rinjtë si të papërvojë për të qenë pjesë e institucioneve vendimmarrëse, të tilla si udhëheqja e partisë, parlamenti, qeveria dhe këshillat bashkiakë dhe kjo mendësi është një pengesë shqetësuese. (Nevila Xhindi dhe Blerjana Bino, 2019)

Në këtë drejtim, PD ka krijuar një trend pozitiv me krijimin e Komitetit për Orientimin e Politikave (KOP), një instrument i fuqizimit dhe mundësitit të pjesëmarrjes së të rinjve në politikë<sup>6</sup>. Iniciativa e KOP, anëtarëve të rinj të saj dhe propozimet e saj të politikave, u promovuan kryesisht në media dhe sferën publike gjatë fushatës zgjedhore të 2005 si një lëvizje inovative dhe pozitive jo vetëm brenda PD, por edhe për të gjithë sistemin politik. KOP krijoi mundësinë për të hapur PD jo vetëm për njohuri dhe ekspertizë nga ekspertë të rinj të ndritshëm, por veçoi si një mekanizëm për të rritur përgjegjësinë e udhëheqjes së PD për të informuar mbi çështjet kryesore të politikës dhe vendimmarrjes. Z. Lulzim Basha, koordinatori i ri i KOP asokohe vlen si shembulli që mbërriti deri në krye të PDSH. Ai u zgjodh si kryetar i PDSH në

<sup>6</sup> Përbërja e KOP nuk dihet zyrtarisht. Emrat e treguar në media në atë kohë janë diku midis 39 - 45, ku rreth 20 prej tyre janë të rinj nën 35 vjeç.

2013-ën. Prej 2005-ës, KOP-i tërhoqi gjithnjë e më pak vëmendjen e mediave dhe publikut, duke qenë se nuk kishte më mbledhje të KOP. (Nevila Xhindi and Blerjana Bino, 2019).

Në ndryshimet staturore të vitit 2009, PD e përcaktoi KOP si një strukturë e brendshme partie e ngarkuar me hartimin, propozimin dhe zbatimin e projekteve politike. Në nëntor 2014, Z. Basha prezantoi për publikun, 24 emra të rinj si "koordinatorë", të gjithë të rinj në moshë, me profile të larta profesionale që iu bashkuan PD nga akademia dhe shoqëria civile.

Sidoqoftë, PD iu rikthye KOP në ndryshimet e reja staturore në vitin 2018. Të paktën në parim, statuti aktual i PD detajon rolin e Komitetit për Orientimin e Politikave si një strukturë që ushqen zgjedhjet dhe programet e politikave të PD me njohuri dhe eksperience profesionale ekspertësh. (Statuti i PD. Neni 60) Besueshmëria dhe tërheqja e të rinjve ndaj FRPD varet gjithashtu nga hapja dhe përfshirja e tyre në strukturat e saj. Hapja e FRPD ndaj individëve që dëshirojnë të përfshihen, konkurrenca e brendshme për avancimin e karrierës brenda forumit, pa dyshim që ndikon në përfshirjen politike të të rinjve në PD. FRPD duke rritur cilësinë e kandidatëve nga radhët e të rinjve përmes konkurrencës, meritokracisë dhe demokracisë rrit besimin e qytetarëve tek PD duke dhënë shpresë që kur ajo të jetë në pushtet, do t'i përmbahet të njëjtave parime.

## Gjendja aktuale në FRPD

FRPD u themelua në vjeshtën e vitit 1991, prej një grupi studentësh që ishin pjesë e lëvizjes së studentëve të dhjetorit '90 dhe anëtarë të PD<sup>7</sup>. FRPD ishte organizata e parë rinore politike e krijuar në skenën e re pluraliste shqiptare. Ajo përfshin demokratët e rinj 15-35 vjeç<sup>8</sup>.

FRPD është organizata partnere rinore e Partisë Demokratike të Shqipërisë (Statuti i PD 2018; neni 70), që vepron nën PD. Të rinjtë universitarë janë të organizuar brenda FRPD në Grupin Rinor të Universitetit Demokratik (GRUD), një strukturë joformale, subjekt i të njëjtave kriterë të organizimit dhe funksionimit si Forumi. (Statuti i FRPD, neni 16).

Deri më sot, FRPD e ka përcaktuar veten në statutin e saj (qershor 2016) si një organizatë politike, shoqërore e të rinjve shqiptarë me një tendencë politike të qendrës së djathtë, e cila në partneritet me Partinë Demokratike mundëson pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën politike, sociale dhe ekonomike të vendit (Statuti i FRPD, neni 1).

<sup>7</sup> PDSH u krijua në Dhjetor 1990 nga lëvizja studentore antikomuniste dhe ishte partia e parë politike e opozitës në Shqipëri në atë kohë me mbështetjen e gjerë qytetare.

<sup>8</sup> Shqipëria që nuk ka ende një përcaktim ligjor të moshës për të rinjtë. As në Kushtetutën Shqiptare rinia nuk përmendet si një koncept ligjor. Dokumenti i vetëm i rëndësishëm i politikës rinore është Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, në të cilin përkufizimi i moshës së të rinjve është përshtatur në 15-29 vjeç. I njëjti përcaktim i moshës përdoret nga Instituti Kombëtar i Statistikave INSTAT, bazuar në kërkesat statistikore. Duke marrë parasysh që moshë mesatare në Shqipëri është 35 (Census, 2011) dhe pjesëmarrja e dobët e të rinjve në vendimmarrje dhe politikë në Shqipëri, për këtë studim ne do të përcaktojmë "të rinjtë" si njerëz të moshës 15 deri 35 vjeç.

Statuti i FRPD paraqet një pamje të detajuar të organizimit qendror dhe lokal të FRPD, me struktura të përshtatshme të cilat kanë për qëllim lidhjen me elektoratin e ri dhe qytetarët në përgjithësi. Sfida mbetet në funksionimin aktual dhe funksionimin e strukturave efikase për të arritur performancën zgjedhore.

## 2. Opsionet për politika

### Performanca e demokracisë së brendshme në FRPD

Funksionimi i brendshëm dhe qeverisja e FRPD parashikohen në statutin e saj, rregulla dhe rregullore, si dhe në kodet e sjelljes dhe etikës të zhvilluara nga forumi për të mbarsur një kulturë të veçantë që përcakton karakterin institucional të forumit rinor.

FRPD ka eksperimentuar në shkallë të ndryshme zgjedhjet e brendshme dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Në statutin e ri, thuhet se parimi "një anëtar, një votë" përfshin zgjedhjen e kryetarit të forumit dhe do të përdoret në zgjedhjen e kandidatëve për forume lokale të rinisë gjithashtu; emërimet nga baza e anëtarësisë të kandidatëve për kryebashkiakë, këshillat vendorë dhe anëtarët e parlamentit dhe vendimmarrja më gjithëpërfshirëse nga forumet qeverisëse të PD. Një tjetër risi është vendosja e procesit të vlerësimit. Statuti i ri (2016) garanton që procesi i përzgjedhjes së kandidaturës është i hapur për propozime; bazuar në kriteret e shpallura; transparente dhe me kohën e nevojshme; bazuar në parimin e "një anëtar, një votë" të anëtarësisë së plotë në FRPD; dhe më në fund votimi në Këshillin Kombëtar. (Statuti i FRPD, neni 21,22).

Statuti i FRPD specifikon organizimin e tij lokal (neni 17) dhe qendror (neni 31). Në kushtet e organizimit qendror, statuti përcakton organet vendimmarrëse, organet ndihmëse dhe strukturat e degëve siç tregohet më poshtë:

*Tabela 1. Organizimi i FRPD*

Organet qendrore vendimmarrëse të FRPD janë:	Organet qendrore ndihmëse të FRPD janë:	Organizimi i degës:
a) Asambleja Kombëtare;	a) Zëvendëskryetarët	a) Kryesia (17-31 pjesëmarrës)
b) Këshilli Kombëtar;	b) Sekretarët Funkcionalë;	b) Kryetari
c) Kryetari i FRPD;	c) Departamentet;	c) Zëvendëskryetari
d) Kryesia e FRPD;	d) Zëdhënësi	d) Sekretari
	e) Financieri	e) Anëtarët

e) Sekretari i Përgjithshëm.			
------------------------------	--	--	--

Burimi: Autorët bazuar në Statutin e FRPD 2016, neni 17 dhe 31

Në fund të vitit 2015, FRPD mbylli procesin e saj të parë historik të votimit për zgjedhjen e kryetarit të saj bazuar në standardin e votimit “një anëtar - një votë”. Për herë të parë, pesë kandidatë (tre të rinj dhe dy të reja) hynë në konkurrencë. Fushata zgjedhore ishte thelbësore dhe përfshiu të gjithë të rinjtë demokratë në të gjithë Shqipërinë. Në të njëjtën kohë, një pjesë e sfidës ishte votimi për kandidatët lokalë për kryetarë në degët e FRPD, duke ofruar një model pozitiv të paprecedentë në atë kohë, të aplikuar nga vetë PD në strukturat e veta lokale dhe qendrore (Krasniqi, 2017). Më 4 qershor 2016, gjashtë muaj pas zgjedhjes së kryetarit të FRPD, u organizuan zgjedhjet për Këshillin Kombëtar të Forumit Rinor dhe u miratua statuti i ri i organizatës. Në fakt, ndryshe nga pritshmëritë, kishin kaluar 10 muaj kur FRPD zgjodhi kryesinë, koordinatoret dhe sekretaritë. Në tetor 2016, FRPD zgjodhi Sekretarin e Përgjithshëm, pesë nënkryetarë, 20 shefa departamentesh dhe 9 sekretarë, 53<sup>9</sup> krerë lokalë të FRPD, secili prej pozicioneve me një mandat katër vjeçar, numri më i madh i pozicioneve udhëheqëse në historinë e kësaj organizate.

FRPD gjithashtu ka krijuar departamente tematike (neni 40 i Statutit), të cilët janë përgjegjës për përgatitjen e platformave, mendimeve, strategjive dhe programeve sektoriale të të rinjve, të cilat shërbejnë për të formuluar programin zgjedhor për të rinjtë dhe veprimtarinë politike të FRPD. Ata emërohen nga Kryesia e FRPD me propozim të Kryetarit. Sidoqoftë, këto struktura duket se kanë funksione paralele dhe të dublikuara dhe kontributi i tyre i mirëfilltë në programin PD mbetet i kufizuar.

Njësitë organizative në nivelin lokal janë seksionet, grup-seksionet dhe forumet lokale për të rinjtë, të njëjtat si në PD. Një degë e PD-së zakonisht funksionon bazuar në njësitë e qeverisjes vendore ose në çdo ndarje tjetër administrative të përshtatshme territoriale dhe përbëhet nga grupe dhe seksione të vendosura në të. PD dhe FRPD operojnë në 60 degë (<https://pd.al/deget/>).

Në nenin 17 flitet për organizimin lokal të FRPD. Një degë ka disa struktura që pasqyrojnë strukturën qendrore të FRPD dhe kryetari i degës zgjidhet nga anëtarët e degës. Kryesia e degës përbëhet nga 17-31 anëtarë të zgjedhur në parimin e "një anëtar një votë". Për degë të veçanta, ky numër mund të rritet me vendim të Kryesisë së FRPD. Çdo degë ka një sekretar, i cili emërohet nga Kryetari i Forumit në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe me miratimin e kryesisë së FRPD, sipas procedurave të përcaktuara në aktet e tjera statutores.

<sup>9</sup> Në vitin 2016 kishte 53 forume lokale për rininë e FRPD, njësoj si PD. Pas rishikimit të Statutit të PDSH-së në 2018, ndodhi riorganizimi i forumeve lokale të të rinjve, me 60 gjithsej. Ky riorganizim u reflektua edhe nga FRPD.

FRPD në veprimtarinë e saj ka treguar një qasje pozitive ndaj të rinjve të marginalizuar që kërkojnë t'i bashkohen programit të saj, manifestit politik dhe shoqëror. Forumi ka anëtarë nga të gjitha pakicat si romët, anëtarë nga të gjitha fetë, nga të gjitha qytetet, zonat rurale, dhe të rinj me mundësi financiare të ndryshme.

Gjithashtu, meqenëse forumi rinor i PD-së është i lidhur ngushtë me historinë politike të PD-së, vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të përfaqësimit të atyre të rinjve që vijnë nga familje të përndjekura politike . dhe njerëz të marginalizuar nën regjimin komunist.

Forumit rinor i FRPD ka garantuar përfaqësimin e femrave në strukturat politike, ku ato kanë forcuar kuotën e përfaqësimit në të paktën 30% të femrave në të gjitha strukturat drejtuese. Në kryesi dhe këshillin kombëtar të FRPD, kjo përqindje e përfaqësimit është zbatuar me saktësi. Lidhur me përfaqësimin dhe zgjedhjen e femrave si drejtuese të strukturave të forumit rinor në degët / rrethet, FRPD është një hap përpara jo vetëm për partinë që i përket, por çdo forum partie dhe rinie në Shqipëri. Këtu duhet përmendur fakti që në shumë qytete, por veçanërisht në zonat me një mentalitet të fortë mashkullor, degët e të rinjve FRPD drejtohen nga femra. Përkatësisht në Burrel, Puke, Kamëz, Skrapar, Korçë, Vlorë dhe Kurbin, femrat janë kryetaret e forumit rinor dhe kanë bërë të mundur përfshirjen e femrave të tjera në strukturat e FRPD. Gjithashtu, në GRUD (Grupi Rinor Universitar Demokrat), sekretarja e përgjithshme e kësaj strukture është një femër. Kjo ka çuar në një numër në rritje të femrave që marrin pjesë në takimet e FRPD.

Në parim, FRPD ka ndërtuar demokraci të brendshme duke lejuar pjesëmarrjen e të gjithë anëtarësisë në zhvillimet e brendshme dhe vendimet politike. Parimet ligjore janë implementuar në statutin e FRPD, në rregulloren e brendshme dhe janë implementuar në praktikë.

Sidoqoftë, FRPD, duke përqafuar dhe praktikuar vërtet demokracinë e brendshme, duhet të jetë një inkubator politik për të ushqyer kulturën politike, mësimin, shoqërizimin dhe kompetencën e qytetarëve të të rinjve dhe për të ofruar mundësi për pjesëmarrje të të rinjve femra, komuniteteve të marginalizuara, të rinjve të pakicave për të mbështetur dhe zgjeruar aftësitë e tyre qytetare. Duke nxitur gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen e mirëfilltë, FRPD do të jetë në gjendje të rrisë legjitimitetin dhe besueshmërinë e zgjedhjeve të politikave dhe alternativave që do të prodhojë në të ardhmen për PD që qeveris vendin.

### **Transparenca financiare dhe llogaridhënia në FRPD**

Financimi është thelbësor për një forum politik rinor për të luajtur rolin e tyre të duhur si agjentë kryesorë të demokracisë. Varësia financiare dhe mungesa e fondeve është një çështje kryesore shqetësuese për FRPD. Sot, kuotat e anëtarësisë luajnë një rol të parëndësishëm si burim fondesh. Është e kuptueshme që në rrethanat kur shumica e elektoratit përballet me varfëri si rezultat i së kaluarës së tyre të pafavorshme nën komunizëm dhe papunësisë aktuale, kuotat e anëtarësisë nuk bëjnë një ndryshim të rëndësishëm as në parti dhe as në buxhetin e forumit rinor. Prandaj, forumi rinor ka tendencë të mbështetet në financime nga burime të tjera.



Mungesa e një buxheti të dedikuar nga PD pengon çdo nxitje në pjesëmarrje dhe përfaqësim të të rinjve në procesin e vendimmarrjes brenda partisë. Fuqizimi politik i të rinjve nuk mund të arrihet nga forume rinore të pafuqishme që varen në çdo hap të rrugës nga financimi prej udhëheqjes së partisë, ata duhet të krijojnë fondet e veta për të drejtuar aktivitetin e forumit, duke filluar me kuotën e anëtarësimit, e cila ekziston në statut, por nuk ka ndodhë në realitet.

Duke marrë parasysh shpenzimet e shumta, të nevojshme për drejtimin e një forumi rinor, FRPD nuk ka sot burimet e nevojshme për të mbështetur anëtarët e vet me trajnim, ose për të organizuar ngjarje dhe aktivitete në komunitetin e tyre. FRPD shpesh ka përfituar nga burimet e financimit të organizatave të huaja si KAS, DeutschlandTag dhe WFD.

Mungesa e informacionit mbi sasinë e parave që qarkullojnë brenda dhe rreth zgjedhjeve, burimet e tyre dhe shpenzimet e bëjnë më të vështirë për të rinjtë të marrin vendime të informuara. Kjo mungësë informacioni gjithashtu lehtëson korrupsionin dhe prish besimin e të rinjve në institucionet politike. Transparenca financiare e fondeve duhet të përmirësohet ndjeshëm në të ardhmen. Diskutimi në grup i të rinjve tregoi se forumi në vetvete mund të punojë më shumë për këtë çështje delikate dhe të rëndësishme për të rritur besimin e të rinjve.

### **Edukimi për qytetari aktive**

Demonstratat masive publike të studentëve në Tiranë në dhjetor 2018 dhe gjatë pranverës 2019 dhe shkalla e ulët e pjesëmarrjes së votuesve të rinj në zgjedhje kanë ngritur pyetjen në lidhje me përgatitjen e të rinjve për të marrë pjesë si qytetarë në shoqëri. Diskutimi në fokus grup me anëtarë të FRPD tregoi se edukimi qytetar dhe politik i të rinjve ka ndikimin më të madh në pjesëmarrjen politike.

Pothuajse 75% e të rinjve FRPD kanë marrë pjesë në seanca trajnimi dhe janë të informuar për çështjet e edukimit politik, mendimit kritik dhe integritetit. Të rinjtë konfirmuan se kanë marrë pjesë në shumë trajnime të organizuara në mënyrë specifike nga KAS, në shumë seanca informimi të organizuara nga NDI, WFD, Fondacioni i PD "Liri Demokraci". Sigurisht, ata theksuan se FRPD dhe PD duhet të vazhdojnë të merren me edukimin e të rinjve mbi çështjet politike të integritetit politik.

Në një kohë kur shumë të rinj po shprehin një "interes të ulët tek politika", pjesëmarrja e të rinjve mund të promovojë qytetari aktive dhe të ofrojë mundësi të reja për angazhim qytetar, edukim dhe mësim rreth qeverisjes, duke forcuar kështu përgjegjësinë sociale të të rinjve. Prandaj, FRPD duhet të promovojë edukimin që përqendrohet në mendimin kritik politik, fleksibilitetin dhe të menduarit sistematik dhe ndërdisiplinor, i cili përputhet me nevojat reale të të rinjve politikë.

## **Pjesëmarrja e FRPD në platformat rinore politike europiane**

Pjesëmarrja në platformat ndërkombëtare të të rinjve është një mënyrë për të rritur rëndësinë e FRPD brenda dhe përtej BE-së, dhe gjithashtu për të arritur rrjetëzimin përmes dialogut të institucionalizuar dhe thelbësor me homologët politikë në të gjithë botën. Përveç kësaj, pjesëmarrja në platforma të tilla e ndihmon FRPD të marrë mbështetje dhe ndihmë teknike, të rrisë besueshmërinë e saj dhe të shkëmbejë praktikë mbi zhvillimet politike dhe performancën zgjedhore.

FRPD është anëtar themelues dhe me të drejta të plota i YEPP (Rinia e EPP, Forumi Rinor i Partisë Popullore Evropiane) që nga viti 1997. Që nga Shkurti i vitit 2020, pas dy viteve të bashkëpunimit intensiv dhe monitorimit nga EDS, FRPD është anëtar me të drejta të plota i EDS (Studentët Demokratë Evropian, Organizata Studentore e EPP) Që nga tetori 2019, gjatë takimit vjetor në Romë, FRPD u bë anëtar i YCDI (Young Central Democrat International), një organizatë që përbëhet nga forume rinore në qendër dhe në të djathtë nga më shumë se 30 shtete në botë. FRPD është gjithashtu një anëtar me të drejta të plota i organizatës DEMYC (Komuniteti Rinia Demokratike e Evropës) dhe IYDU (Bashkimi Ndërkombëtar i Demokratëve të Rinj), e cila përfshin 127 forume të djathta nga 81 vende të ndryshme të botës.

Sekretariati i punëve të jashtme të FRPD përbëhet nga 10 të rinj, të mirë-arsimuar dhe entuziastë, shumë aktivë në promovimin e vlerave të të rinjve shqiptarë dhe angazhimin e tyre politik në PD.

Arritjet e jashtëzakonshme të FRPD në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk duhet të merren si të mirëqena nga PD. Kjo detyrë është shumë e rëndësishme sot, sepse mbështetja nga aktorët ndërkombëtarë është gjithnjë e më e nevojshme.

## **Përfaqësimi rinor në organin më të lartë vendimmarrës në PD**

Përfshirja e të rinjve në proceset politike të PD është një sfidë komplekse dhe shumë dimensionale që duhet adresuar me një larmi mjetesesh, në varësi të objektivave dhe kontekstit të partisë. Nëse të rinjtë FRPD kanë perceptimin se proceset zyrtare politike nuk janë të arritshme dhe / ose tërheqëse për ta, kjo mund të formojë qëndrimet e tyre për gjithë jetën, me ndikime të mundshme afatgjata negative në kulturën politike të vendit.

Statutet dhe rregulloret e PD përfshijnë role, detyra dhe përgjegjësi specifike për forumin e saj rinor, edhe pse disa nga këto funksione janë të kufizuara ose në disa raste vendosen bazuar në kuota dhe proporcione

të caktuara. Statuti i PD ka përcaktuar përfaqësimin e të rinjve 15% në organin më të lartë vendimmarrës të PD, në Këshillin Kombëtar, 10% në këshillat bashkiakë vendorë dhe 5% në Parlamentin Shqiptar.

Gjithashtu, kryetari i forumit rinor (FRPD) është automatikisht anëtar i kryesisë. Të gjitha këto ndryshime u arritën në ndryshimet e miratuara të Statutit të PD të vitit 2018, në të cilën pati një rritje të rolit dhe vendimmarrjes së të rinjve në strukturat e partisë. Hapësira e vetme ende e papërdorur, dhe e cila do të ishte një ndihmë e madhe për FRPD, do të ishte garantimi i një përqindje të caktuar të buxhetit të alokuar PDs nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për organizimin e aktiviteteve të forumit rinor dhe shpenzime të tjera.

*Tabela 2. Përfaqësimi i të rinjve sipas statutit të PD*

<b>Këshilli Kombëtar</b>	<b>Këshilli Bashkiak</b>	<b>Kuvendi i Shqipërisë</b>
15%	10%	5%

Burimi: Statuti i PD, 2018.

Megjithëse ka pasur një përmirësim të lehtë në pjesëmarrjen e të rinjve në institucionet vendimmarrëse në Shqipëri siç janë parlamenti dhe qeveria, ekziston ende një mospërputhje e lartë midis të rinjve të emëruar dhe atyre të zgjedhur. Të rinjtë vihen në fund të listave të nominimeve (lista në Zgjedhjet Parlamentare 2017) gjë që ul shanset për t'u zgjedhur dhe siç do të vërehet më poshtë nivele të ulëta të pjesëmarrjes së të rinjve gjenden gjithashtu në strukturat e rëndësishme politike të PD. PD ka 16.1% të rinj si anëtarë të FRPD në këshillin e saj kombëtar (56/350), ndërsa 8% e Kryesisë së Partisë (3/28) përbëhet nga të rinj. Nga kjo pikëpamje (numrat dhe përqindjet), mundësitë e përparimit për të rinjtë për të marrë pjesë në jetën politike të PD dhe për t'u përfaqësuar respektohen zyrtarisht, por zëri dhe iniciativat e tyre duhet të dëgjohen jo vetëm zyrtarisht, por në terma realë.

Argumentet e PD për rritjen e përfaqësimit të të rinjve janë paralele me ato të rritjes së numrit të grave<sup>10</sup>. Ashtu si ka një dështim në përfaqësimin gjinor, PD nuk ka arritur të integrojë të rinjtë në drejtimin më të madh politik të partive. Duhet të theksohet se rinia përbën një pjesë të madhe të votuesve të PD, dhe për


<sup>10</sup> Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ka vendosur një kuotë minimale hyrëse për gratë me 30 përqind të kandidatëve në zgjedhjet parlamentare dhe 50 përqind për këshillat bashkiakë, por nuk ka asnjë diskriminim pozitiv për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje. Në të njëjtën kohë, ligji "Për Partitë Politike në Shqipëri" nuk e cek fare një temë të tillë. Ligji Nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike"

këtë arsye duhet bërë më shumë përpjekje për të siguruar një hapësirë për përfshirjen e kësaj elektorale në proceset e vendimmarrjes politike.

Të rinjtë në parlamentin e Shqipërisë


Sipas të dhënave (KQZ 2020), përqindja e kandidatëve për të rinjtë në listën e PD për zgjedhjet parlamentare, Tabela 5, është pothuajse dyfishuar nga zgjedhjet e 2013 në 2017. Kjo është një shenjë e mirë për përfshirjen e të rinjve demokratë në politikën reale. E njëjta rritje është ndjekur, siç tregohet në Tabelën 6, ku përqindja e vendeve të të rinjve të PD në parlament krahasuar me numrin e përgjithshëm të vendeve është rritur në 2017. Nuk ka një shpjegim specifik për rënien e përqindjes së të rinjve pjesëmarrës në listë për kandidim si dhe në përfaqësimin në parlament për vitin 2013.

Tabela 3. Përqindja e kandidatëve të rinj në listën e PD për zgjedhjet parlamentare



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e marra nga KQZ (shtator 2020)

Tabela 4. Përqindja e vendeve të të rinjve të PD në parlament



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e marra nga KQZ (shtator 2020)

Të rinjtë e FRPD janë të shqetësuar për përfaqësimin e tyre në përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të prillit 2021. Megjithatë partia filloi një proces me rëndësi politike për zgjedhjen e kandidatëve, të rinjtë e FRPD nuk u përfshinë në komisionet e përzgjedhjes, dhe jo vetëm, por edhe kur ata u emëruan nga anëtarësia, emrat e tyre nuk kandiduan për një raund të dytë. Shqetësimi i tyre u ngrit gjatë diskutimit në fokus grup si dhe fakti që nga zgjedhjet e një raundi në tjetrin, anëtarët e FRPD ishin më pak të përfaqësuar.

Sigurisht, ka shumë të rinj në listën e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare ose lokale, por shumica e tyre nuk janë anëtarë të FRPD. Pjesëmarrësit e fokus grupit deklaruan se PD i konsideron anëtarët e FRPD shpesh në listat fillestare, por jo gjithmonë këta të rinj, të rritur politikisht në strukturën rinore të partisë, arrijnë të jenë në listat përfundimtare, sepse të rinj të tjerë që vijnë nga sfera akademike dhe shoqëria civile bëheni pjesë e listës fituese, shumë më shpejt se të rinjtë e FRPD.

Përfshirja e të rinjve të PD në parlament dhe poste të tjera të zgjedhura mund të luajë një rol të rëndësishëm në motivimin e të rinjve për t'u përfshirë më politikisht, duke demonstruar se politika është e hapur për pjesëmarrjen e tyre dhe duke siguruar modele të mundshme të roleve. Me fjalë të tjera, nëse të rinjtë përbëjnë një pjesë të madhe të popullsisë (29.4%), ata meritojnë më shumë sesa një prani simbolike në institucionet legjislativë për arsye të drejtësisë dhe legjitimitetit demokratik.

### Të rinjtë në këshillat bashkiakë në Shqipëri

Kur shohim të dhënat për Kryebashkiakët, duke pasur parasysh zgjedhjet e 2011-ës, vëzhgojmë se kanë qenë në total 76 kryebashkiakë, prej të cilëve vetëm katër ishin nën 35 vjeç dhe vetëm një prej tyre nga Partia Demokratike. Asnjë prej të zgjedhurve nën 35-vjeç nuk ishte grua.

Ndërkohë që në zgjedhjet lokale të 2015-ës<sup>11</sup>, kemi një rritje të vogël me 3% të Bashkive të udhëhequra nga të rinj nën 35 vjeç, ndërkohë që 92% e Bashkive në vend vijuan të drejtoheshin nga persona mbi këtë moshë. Rezultatet e zgjedhjeve lokale të 2015-ës tregojnë se nga PD, vetëm kryebashkiaku i Devollit ishte nën 35 vjeç.

Të dhënat për Këshillat Bashkiakë në Shqipëri (KQZ 2020) bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2011, tregojnë se rreth 85% e anëtarëve të Këshillave Bashkiakë ishin mbi 35 vjeç, ndërsa vetëm 10% e tyre i përkisnin moshës nën 35 vjeç. Informacioni mbi moshën mungon për anëtarët e këshillit të qytetit në shumicës e rasteve Kur krahasohet me kryetarët e bashkive, kjo është një shifër disi më e lartë, por përsëri në vlera absolute, përfaqësimi i të rinjve nëpër Këshillat Bashkiakë në Shqipëri mbetet shumë i ulët.

Ndërsa rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2015<sup>12</sup>, sjellin një pamje pothuajse krejtësisht të ndryshme, ku vërejmë gati një trefishim të përfaqësimit të të rinjve nëpër Këshillat Bashkiakë. Nga 10% e përfaqësimit të të rinjve në 2011 në fund të zgjedhjeve të qershorit 2015, të rinjtë përbëjnë 26.4% të të gjithë anëtarëve të këshillave bashkiakë, duke zvogëluar mjaft përfaqësimin e personave mbi 35 vjeç në këshillat bashkiakë. Megjithatë nuk është bërë ende një analizë e detajuar e të gjithë faktorëve që çuan në këtë rritje të konsiderueshme të numrit të të rinjve në Këshillat Bashkiakë, ne besojmë se vendosja e kuotës së barabartë gjinore për kandidatët, e kombinuar me një presion të shtuar ndaj politikanëve për rinovimin e klasës politike në Shqipëri, janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë.

Të dhënat e përshkruara në Tabelat më poshtë (shih Tabela 7) tregojnë se në zgjedhjet lokale 2011, kishte gjithsej 183 të rinj nën 35 vjeç të zgjedhur në këshillat lokale në të gjithë vendin, dhe Partia Demokratike përfaqësohet me 28 prej tyre ose 15.3%.


Zgjedhjet lokale të qershorit 2015 në përgjithësi prodhuan rezultate pozitive për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen lokale, krahasuar me rezultatet e vitit 2011. Të rinjtë kishin 394 vende në të gjithë vendin.

<sup>11</sup> Shqipëria kishte aplikuar për herë të parë një sistem të ri të ndarjes administrative, ku njësitë më të vogla të organizatave administrative (komuna) u eliminuan të gjitha dhe vendi u nda në 61 bashki të reja.

<sup>12</sup> Shqipëria kishte aplikuar për herë të parë një sistem të ri të ndarjes administrative, ku njësitë më të vogla të organizatave administrative (komuna) u eliminuan të gjitha dhe vendi u nda në 61 bashki të reja.

Sidoqoftë, siç tregohet në Tabelën 5, numri i këshilltarëve të PD ka një rritje të lehtë në numra absolutë, por një rënie në përqindje. Nga një total prej 394 të rinjsh nën 35 vjeç të zgjedhur në këshillat vendorë në të gjithë vendin, Partia Demokratike përfaqësohet me 30 prej tyre ose vetëm 7.6%.

Tabela 5. Në shifra, përfaqësimi i të rinjve në këshillat bashkiakë: Zgjedhjet lokale 2011 dhe 2015



Burimi: Autorët bazuar në të dhënat e marra nga PD dhe KQZ (Shtator 2020)<sup>13</sup>

PD duhet t'i kushtojë vëmendje diferencimit midis përfaqësimit / pjesëmarrjes politike kuptimplotë të të rinjve dhe aktiviteteve tokeniste<sup>14</sup>, pseudo-pjesëmarrëse. Disa aktivitete që pretendojnë të nxisin pjesëmarrjen politike të të rinjve nuk u japin të rinjve në mënyrë efektive një zë dhe ndikim në vendimmarrje. Prandaj, për të garantuar që pjesëmarrja nuk do të jetë një ngjarje e vetme, duhet të ekzistojnë mekanizma për të siguruar ndjekjen, zbatimin e vendimeve për të rinjtë dhe llogaridhënien në elektorale të rinisë. Qasja e Forumi Rinor të PD ndaj të rinjve duhet të jëtë per ti nxitur ato të marrin pjesë dhe të dëgjohen.

Ekzistenca e modeleve pozitive të politikanëve të rinj dhe promovimi i tyre në sferat sociale, politike dhe mediatike tregon se investime të mëtejshme në promovimin e përfaqësimit politik të të rinjve janë të nevojshme për të arritur qëndrueshmërinë dhe suksesin. Zbatimi integral i ligjit të de-kriminalizimit mund të krijojë një mjedis të favorshëm për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në partitë politike dhe parlament. Asnjë politikan i ri si në sistemin qendror ashtu edhe në atë lokal të përfaqësimit nuk është përfshirë në listën e politikanëve të penalizuar për shkak të dispozitave të këtij ligji ose të dhënave penale.

<sup>13</sup> Ne kemi hasur probleme në gjetjen e statistikave për zgjedhjet e këshillit lokal. Lista e PD-së nuk ishte e plotë, një listë shumë e kufizuar e kandidatëve vetëm për disa rrethe dhe KQZ-ja nuk kishte një listë të plotë të emrave për secilin këshill bashkiak dhe gjithashtu asnjë informacion në lidhje me moshën e kandidatëve. Kjo e ka bërë shumë më të vështirë krahasimin e shifrave me zgjedhjet lokale 2011 dhe 2015. Numrat e marrë janë nga rrumbullakimi statistikor i vlerave të dhëna nga KQZ dhe PD.

<sup>14</sup> Tokenizmi është kur të rinjve u duket se u është dhënë një zë por kanë pak ose aspak zgjedhje për mënyrën se si marrin pjesë.

PD duhet të inkurajojë përfshirjen në strukturat partiake të më shumë të rinjve dhe grave me profile të ndryshme, të arsimuar mirë, që përfaqësojnë grupime të ndryshme shoqërore, si dhe rekrutimin e kandidatëve të rinj politikë bazuar në disa kritere, konkurrencën e platformës dhe idetë politike.


### **Fushat me prioritet për rininë në zgjedhjet kombëtare të 2021**

Për qëllimet e këtij studimi, i cili synon edhe të njohë dhe të vlerësojë pritshmëritë e të rinjve kundrejt programit politik të PDSH-së për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, veçanërisht sa i përket sferave kryesore që PDSH ka nevojë të trajtojë në programin e saj, si për shembull, arsimimin, punësimin, çështjen e emigracionit, përfshirjen shoqërore dhe ndikimet e pandemisë Covid-19, ne organizuam një analizë shumë të thjeshtë online, të titulluar “Të rinjtë për Shqipërinë” me anëtarë nga FRPD.

Një ndër pyetjet më të rëndësishme ishte “Cilin nga sektorët e mëposhtëm do ta konsideroni një përparësi për të rinjtë? Të rinjtë u përgjigjen përkatësisht se përparësitë e tyre ishin 43% arsimit; 35% sipërmarrja; 12% turizmi; 6% shëndetësia dhe 4% bujqësia. Transformimi i shpejtë ekonomik, shoqëror, politik dhe kulturor në shoqërinë paskomuniste shqiptare, e vendosi sistemin arsimor përballë nevojave dhe domosdoshmërive shumëpërmasore ndaj vazhdon të jetë në krye të listës së prioriteteve.



Tabela 6. Fushat prioritare të të rinjve për zgjedhjet kombëtare 2021



Burimi: Pyetësori online, tetor 2020

Duke u mbështetur te programi i PDSH-së së viteve të fundit, që kohë pas kohe është rishikuar dhe rishqyrtuar, qasja politike e PDSH-së për përfshirjen e të rinjve duhet të synojë të jetë programi i një partie europiane të qendrës së djathtë, i përshtatur në kontekstin shqiptar, me një vëmendje gjithnjë e më të rritur karshi arsimimit, sipërmarrjes, politikave rinore dhe promovimit të konkurrencës, meritokracisë dhe karrierës politike.

### COVID-19 dhe të rinjtë në Shqipëri

Emergjenca shëndetësore e shkaktuar nga epidemia e COVID-19 dhe ndikimet e saj ekonomike dhe shoqërore i kanë ndërprerë pothuajse të gjitha aspektet e jetës për të gjitha grupet e shoqërisë. Por, megjithatë, njerëz të moshave të ndryshme janë duke i përjetuar në mënyra të ndryshme pasojat e saj.

Në Shqipëri, pasojat e pandemisë COVID-19 janë duke i larguar akoma dhe më shumë liderët e rinj nga mundësia e tyre për t'u përfshirë në çështjet politike dhe publike të jetës shoqërore, ashtu si dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje, kjo si pasojë e distancimit shoqëror dhe urdhrave për të qëndruar në shtëpi. Aktivistët e rinj nuk mund të mblidhen më fizikisht për të organizuar lëvizje apo tubime në shkallë të gjerë shoqërore. Mund të përfytyrojmë që edhe plogështia politike mund të jetë shumë e lartë te votuesit e rinj, të cilëve edhe përpara krizës u mungonte besimi te qeveria shqiptare dhe aktorët politikë të saj, dhe ndihen

se të njëjtët udhëheqës dështuan që ta menaxhonin në mënyrë të përgjegjshme dhe të duhur emergjencën e shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Për më tepër, siç PDSH ka vënë në dispozicion energjitë e saj për t'iu përgjigjur situatës së shkaktuar nga pandemia dhe ka vënë në pah mjerimin e grupeve dhe njerëzve më të ekspozuar të shoqërisë, përsëri edhe këtu përfshirja politike e të rinjve ende nuk duket se është një përparësi. Por megjithatë, në mënyrë të ngjashme, iniciativat për rimëkëmbjen socio-ekonomike dhe politike nga një krizë e këtillë paraqet edhe perspektiva të ndryshme të të rinjve për të marrë pjesë në ndryshimin e strukturave dhe praktikave të mëparshme, në mënyrë që ta zgjerojnë praninë e tyre në drejtim dhe qeverisje. Kështu, ndërkohë që nga njëra anë pandemia ka fuqinë t'i dobësojë dhe përjashtojë të rinjtë, nga ana tjetër ata gjithashtu kanë mundësinë për të çliruar energji jetike, të cilat mund të prodhojnë ndryshime midis brezave. Por megjithatë, kontributi i të rinjve në të këtilla nisma varet thelbësisht nga lidhshipi krijues, organizimi dhe vullneti për të rrokur mundësitë.

COVID-19 ka pasur një ndikim drastik mbi të rinjtë në Shqipëri në kuptimin tërësor dhe gjithëpërfshirës të fjalës, para së gjithash për arsyen se ka theksuar akoma edhe më shumë vështirësitë ekzistuese që ata hasin. Me 29.7% të të rinjve të cilët nuk janë as të punësuar, as nuk shkollohen dhe as nuk janë duke u trajnuar për ndonjë gjë (INSTAT, 2017), të rinjtë në Shqipëri kanë përballuar pjesën dërrmuese të pasojave të marginalizimit socio-ekonomik, përkeqësimit të kushteve të përgjithshme të mirëqenies dhe varfërisë së paprecedent. Disa hulumtime na diktojnë se këto shifrat e papunësisë mund të dyfishohen si pasojë e pandemisë, duke shkuar kështu drejt humbjeve të shumta të vendeve të punës, ashtu si dhe të një përkeqësimi të pashmangshëm të mirëqenies.

Edhe përpara epidemisë, të rinjtë shqiptarë kanë pasur probleme madhore të cilat, ç' është e vërteta, buronin nga mungesa e investimeve në shëndetësi, arsim, sipërmarrje, aftësim dhe punësimin e të rinjve. Sektorët joformalë të Shqipërisë që përthithin pjesën më të madhe të papunësisë karakterizohen nga mungesa të thella të sigurisë shoqërore, gjë që personat e punësuar në këta sektorë i dënon të jetojnë në një pasiguri të vazhdueshme. Shtettrëthimi dhe rregullat e shpallura në përgjigje të menaxhimit të krizës së shkaktuar nga COVID-19, kanë ndikuar negativisht në këta sektorë, duke detyruar shumë njerëz që të thellohen në varfërinë e tyre kronike. Për shumë vite, ekonomia e Shqipërisë ka dështuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar mundësi punësimi për të rinjtë, që të përmbushë nevojat e mijëra të diplomuarve nëpër universitete dhe institucione të tjera tretësore.

Momente të tilla ndryshimesh të befta e të përhapura gjerësisht, historikisht kanë prodhuar ndryshime të tjera radikale e të pakthyeshme në dinamikën e pushtetit që, me kalimin e kohës, kanë vënë në lëvizje lidera të rinj të cilët pasi kanë ardhur në krye të vendit, e kanë ndryshuar në mënyrë të pashmangshme qeverisjen

e këtyre shoqërive. Por megjithatë, si të gjitha rrethanat tipike revolucionare, këto momente nuk vijnë në një pjatë të argjenditë; përkundrazi, ato kërkojnë zgjidhje organizative, strategji dhe vendosmëri. Të rinjve shqiptarë u duhet t'i kërkojnë këto ndryshime sepse ata që kanë pushtetin thjesht nuk do t'ua mundësojnë kurrë ato.

Duke kapur mundësitë e një lidhshipi të ri, të rinjtë e FRPD-së do t'u duhet ta pranojnë dhe ta njohin domethënien e qeverisjes në mirëmenaxhimin e çështjeve shoqërore dhe politike. Për të rinjtë, qeverisja duhet të jetë një shqetësim i përditshëm, sepse ajo ndodhet në zemër të shpërndarjes së burimeve, me implikime të jashtëzakonshme për qëndrueshmërinë shoqërore dhe politike. Për shembull, pasojat e epidemisë COVID-19, pjesërisht lidhen me problemet e gjera të qeverisjes që e kanë dëmtuar prej kohësh shoqërinë shqiptare. Njësoj si emergjenca tjetër publike e tërmetit të 26 nëntorit 2019, COVID-19 ka nxjerrë në pah zhgënjimet dhe pamjaftueshmërinë e sistemit të shëndetit publik, pjesa dërrmuese e të cilit u shemb i gjithi, si pasojë e korrupsionit qeveritar dhe keqmenaxhimit të burimeve. Në mënyrë të ngjashme, edhe tërmeti i 26 nëntorit 2019, ka nxjerrë në pah dështimin e qeverisë në marrjen e përgjegjësisë që ka për të furnizuar qytetarët me strehim, ujë të pijshëm dhe shërbim mjekësor.

Rinia shqiptare duhet të jetë në gatishmëri të plotë për këto ndryshime, në mënyrë që të ngrihet dhe të mobilizohet për mënyra të reja të të vepruarit. Këto ndryshime, në shkallë të gjerë, burojnë nga hendeqet që janë krijuar midis udhëheqësve dhe qytetarëve të tyre. Për t'i shmangur këto hendeqe, kërkohet një qeverisje e përgjegjshme dhe llogaridhënëse dhe, në mënyrë më kritike, një qytetari e cila është e informuar dhe e përgatitur për ta nxitur dhe ushtruar presion për një qeverisje më të mirë. Shqipëria ende është peng i institucioneve të dobëta të cilat janë të paafta për të ofruar shërbime publike dhe për të garantuar që të gjithë qytetarët do të trajtohen në mënyrë të barabartë. Kjo është pika ku çështjet e të rinjve shqiptarë vijnë në qendër të vëmendjes: COVID-19 potencialisht të rinjtë shqiptarë i ka projektuar që të jenë pjesë e pozicioneve strategjike që do t'i bëjë ata udhëheqës në ndihmën e rindërtimit socio-ekonomik dhe veprimtarive politike në një të atillë mënyrë që reflektojnë karakterin e punës së vështirë dhe përpjekjeve kolektive për të zgjidhur probleme.

Në botën post-COVID-19, të rinjtë shqiptarë duhet të kërkojnë dhe të jenë të vendosur në bindjen e tyre se nuk mund të ketë kurrësi kthim në normalitet pa përfshirjen e tyre në pozicionet vendimmarrëse. Kjo përfshirje duhet ta tejkalojë praktikën tradicionale të “përfshirjes së të rinjve” që shpesh priret drejt tokenizmit steril. Të rinjtë e kanë bërë hapin e tyre të parë në mbrojtjen shoqërore dhe mobilizimin komunitar në kontekstin e pandemisë COVID-19, por atyre do t'u duhet t'i përshkallëzojnë këto përfshirje, në mënyrë që të marrin pozicione kryesore për të nxitur transformime akoma dhe më themelore. Para së gjithash ata duhet të kërkojnë një vend në tryezën e rimëkëmbjes post-COVID-19, duke ndihmuar në

konceptimin dhe zbatimin e një game të gjerë programesh dhe politikash të denja për t'iu përgjigjur pasojave të pandemisë.

Ndryshimi midis brezave në udhëheqësi dhe qeverisje është një proces i qëndrueshëm që gjithmonë varet nga përfitimi afatgjatë i aftësive, burimeve dhe kapaciteteve. Por megjithatë, momentet e rastësishme si pandemia, kanë prirjen t'i japin udhë nisjes së këtyre transformimeve, duke i pajisur udhëheqësit e rinj me energji, nxitje dhe bindje. COVID-19 ka pasur një larmi pasojash mbi sistemet shëndetësore, ekonomike, shoqërore dhe politike nëpër të gjithë globin. Në Shqipëri, këto pasoja sapo kanë filluar të depërtojnë në sferat më të gjera shoqërore. Por megjithatë, nëse COVID-19 prodhon udhëheqës të rinj dhe ndez ndryshime midis brezave në Shqipëri, ai do të kontribuojë edhe në qasje të reja për administrimin e çështjeve shoqërore dhe politike.

### **Brez i mirarsimuar i të rinjve për një Shqipëri të begatë**

Përmes arsimit, shoqëria dhe kombi transmeton diturinë, kulturën, trashëgiminë dhe vlerat e qytetarëve të saj, përmes së cilave shoqëria përparon. Arsimi është gjithashtu një ndër fushat që drejton në shoqëri, por paraprind ndryshimet sociale të saj. Fakti se sistemet arsimore janë në ndryshim të vazhdueshëm nuk tregon paqëndrueshmëri, përkundrazi, ato shërbejnë për t'iu përshtatur më mirë ndryshimeve në shoqëri. Siç ka ndodhur me arsimin tonë të lartë, ndryshime të shumta që kanë ndodhur këto njëzet vitet e fundit, kanë treguar se arsimi është duke u përpjekur për t'iu përshtatur një shoqërie dinamike, në mënyrë që t'i zbusë ndryshimet shoqërore që kanë ndodhur në vendin tonë, por edhe ato globale. Eksperimentimi në arsim nuk është diçka e keqe, por kur eksperimenti shkon përtej kufijve, atëherë ai bëhet i dëmshëm dhe ka pasoja negative. Reforma e fundit në arsimin e lartë dhe debatet që e kanë shoqëruar atë, vërtetojnë për një publik gjithnjë e më të gjerë, nevojën për vëmendje për problemet në arsim. Këto probleme duket se i përkasin të gjithë shoqërisë dhe jo vetëm një pjese të saj.

Anëtarët e FRPD-së mendojnë se situata aktuale e arsimit të lartë duhet t'i nënshtrohet një reforme radikale, e cila duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe thellësisht demokratike. Reforma e fundit (shtator 2015) në arsimin e lartë dhe debatet që kanë shoqëruar atë, siç e thamë, tregojnë një vetëdije të lartë publike sa i përket problemeve të arsimit. Anëtarët e FRPD-së mendojnë se është e nevojshme që arsimi i lartë shqiptar të jetë në nivelin e praktikave më të mira të Bashkimit Europian.

Sa i përket anëtarëve të FRPD-së, universitetet duhet të tërheqin të rinj të talentuar dhe t'u mundësojnë këtyre studentëve që të aplikojnë për punësim në Shqipëri pasi të diplomohen. Investimet në kërkime dhe inovacione janë investime për të ardhmen e Shqipërisë. Promovimi i investimeve në inovacion dhe kërkime, në ndryshime teknologjike, siguri, mjedis dhe zgjidhja e çështjes së papunësisë së të rinjve, duhet të jenë

përparësi kyçe për qeverinë shqiptare dhe këto mund të arrihen përmes promovimit të arsimimit që fokusohet në të menduarit kritik, sipërmarrjen, aftësitë e buta, fleksibilitetin dhe të menduarit sistemik dhe ndërdisiplinor, të cilat i përmbushin nevojat e vërteta të tregut të punës.

Përgjigje nga anketa online tregojnë se PDSH në programin e saj duhet të fokusohet në shkollat profesionale të fushave si agrobiznesi, gastronomia dhe turizmi, të cilat aktualisht janë në nevojë të madhe për fuqi punëtore të kualifikuar dhe me përvojë dhe që mund të ofrojnë një avantazh cilësor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Të rinjtë në një shoqëri dixhitale**

Partitë politike janë të përqendruara në zhvillime socio-ekonomike dhe kulturore. Si e tillë, PDSH e ka përqaftuar këtë shpirt, duke u shndërruar në forcën e parë politike që i ka kushtuar mandatin e saj të dytë (2009-2013) investimit në teknologjinë digjitale, duke përmirësuar kështu shërbime jetike dhe duke i dhënë një shtytje të konsiderueshme zhvillimit ekonomik të vendit. Në epokën e digjitalizimit, aksesimi në Internet është themelor për mundësitë e barabarta. Në Shqipëri nuk duhet të ekzistojnë kufij virtualë. Anëtarët e FRPD-së besojnë se Shqipëria duhet të krijojë një kornizë të qëndrueshme e të fortë ligjore për teknologjitë e reja të tilla si blockchain, inteligjenca artificiale dhe të tjera për t'u përdorur në jetën ekonomike dhe publike.

### **Të rinjtë dhe ekonomia**

Sa i përket çështjeve ekonomike, PDSH që prej themelimit të saj ka mbështetur reformat liberalizuese ekonomike dhe ka promovuar një model dinamik për ndryshimin ekonomik, me akses në tregun e hapur, pavarësisht kostove shoqërore me justifikimin se kjo garanton rigjallërimin dhe përforsimin e ekonomisë. Qëndrimet ekonomike programatike të PDSH-së dhe vendimmarrja e saj praktike kanë ndryshuar disa herë me kalimin e viteve. Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë, anëtarët e FRPD-së mendojnë se PDSH-së do t'i duhet një kohë e gjatë për ta reformuar dhe përgatitur sistemin tonë ekonomik për sfidat e së ardhmes që ajo do të përballet me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

StartUp-et janë fryma e re dhe themeli i mirëqenies së të rinjve në Shqipëri. Për t'i mbështetur ato edhe më tej, PDSH në programin e saj për zgjedhjet e përgjithshme 2021, duhet të mendojë se si të lehtësojë krijimin e më shumë vendeve të punës, përmes një aksesimi më të lehtë financimi, rregullash më të lehta për fonde investimesh për të mbështetur biznese të reja dhe inovative në të gjithë Shqipërinë, duke inkurajuar kështu diturinë dhe teknologjinë të transferohen nga universitetet dhe institutet kërkimore, drejt një mundësie më të madhe për sipërmarrësit e rinj.

## Të rinjtë dhe bujqësia

Gjatë diskutimeve në fokus grupin 2, anëtarët e FRPD-së diskutuan se cila është mënyra e nevojshme për të përgatitur të rinjtë në zonat rurale, për të trajtuar profesionalisht kulturat bujqësore dhe tokën, ashtu si dhe si t'i përgatisim ata për sipërmarrje në këtë fushë. Disa nga mënyrat mund të jenë si për shembull hapja e fabrikave për përpunimin e kulturave bujqësore që i shërbejnë turizmit dhe eksportit; tjetër mënyrë është promovimi i agro-turizmit dhe nxitja e të rinjve për të qenë lider në këtë sektor të ekonomisë.

## Punësimi i të rinjve

Sipas politikëbërësve, punësimi i të rinjve është “çelësi” për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të një kombi. Profesionistët e rinj të cilët janë të aftë të sigurojnë vende të denja pune japin një kontribut të paçmueshëm ndaj produktivitetit ekonomik kombëtar në tërësi. Përtej rolit të tyre si përfaqësues të pjesës më jetike të fuqisë punëtore, të rinjtë gjithashtu zotërojnë aftësinë për të rritur kapacitetet zhvillimore dhe teknologjike të shoqërisë, t'i avancojnë më tej avantazhet e saj krahasuese ashtu si dhe ta zhvillojë integrimin dhe kohezionin e bashkësisë. Për të arritur një punësim të gjerë të të rinjve, gjitha pikat kyçe të shoqërisë duhet të kapërcejnë sfida të një bashkëpunimi të suksesshëm. Universitetet, bizneset, institucionet qeveritare, investitorët dhe veçanërisht vetë qeveria duhet të bashkëpunojnë për të krijuar rrethanat e duhura e të përshtatshme për ta reduktuar në mënyrë të ndjeshme nivelin e lartë të papunësisë.

Gjithashtu edhe migrimi i vazhdueshëm që prej fillimit të viteve '90 e ka dëmtuar kapitalin njerëzor dhe potencialin për krijimin e vendeve të punës në ekonomi. Aftësitë profesionale të të rinjve shqiptarë janë të ulëta: pavarësisht progresit të studentëve në nota nëpër vlerësimet e tyre ndërkombëtare, ata tregojnë një hendek dijesh që është i barasvlershëm me dy vite e gjysmë shkollorë, kjo sipas mesatares së OECD-së. (Garunja, 2018) Grupe të tjerë gjithashtu vuajnë nga përjashtimi ekonomik dhe shoqëror. Të rinjtë dhe minoritetet janë shpërjstueshmërisht të përjashtuar nga tregu i punës. Për shembull, 27% e të rinjve nuk janë as të arsimuar, as të punësuar dhe as nuk janë duke ndjekur ndonjë trajnim (NEET), dhe papunësia në gjirin e të rinjve është 2-3 herë më e lartë sesa papunësia që haset në fuqinë punëtore të më të rriturve. Përjashtimi nga tregu i punës mundet gjithashtu të shpjerë drejt përjashtimit shoqëror, siç dëshmohet nga të dhënat ndërkombëtare. (Banka Botërore, 2019)

Anëtarët e FRPD-së diskutuan në fokus grupin 1 se Shqipëria duhet të krijojë një *Fond Tranzicioni* për të ndihmuar ata të rinj që kanë humbur vendet e tyre të punës si pasojë e ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe ndikimeve që pandemia e COVID-19 ka shkaktuar. Ata mendojnë se duke punuar fort të gjithë së

bashku me unionet tregtare dhe dhomat e industrisë, do ta reduktojmë ndikimin e pandemisë mbi të rinjtë tanë më të ekspozuar nga pasojat e saj.

Rindërtimi i sistemit të shkollave profesionale do të stimulonte gjithashtu zhvillimin rural dhe lokal, duke krijuar qendra specifike profesionale që do t'i përgatisnin studentët të ishin të aftë për profesione të veçanta teknike në sektorë ku fuqia punëtore është e kërkuar, duke nxitur kështu ciklin e punësimit dhe duke e drejtuar atë drejt zonave më të përshtatshme profesionale që do të shkaktonin produktivitetin më të madh ekonomik.

Punësimi dhe sipërmarrja e të rinjve janë drejtpërsëdrejti të lidhura me mirëqenien e qëndrueshme ekonomike dhe në tërësi shoqërore të kombit. Sigurimi i një punësimi të qëndrueshëm përmbush nevojat dhe pritshmëritë e të rinjve dhe i shpie ata drejt realizimit personal dhe profesional, por në të njëjtën kohë, ai është një dobi për bashkësinë, siguron kohezionin shoqëror, promovon zhvillimin ekonomik dhe përmirëson standardin e jetesës. Realitetet e të jetuarit brenda shoqërisë shqiptare nuk duhet t'i thejnë këto aspirata. Por megjithatë, kriza aktuale e papunësisë ka nevojë për një reagim të menjëhershëm dhe efikas nga të gjithë aktorët kyçë të shoqërisë, përfshirë edhe pjesëtarët individualë të vetë shoqërisë.

## Migrimi i të rinjve

Një studim i vitit 2018 mbi të rinjtë në Europën Juglindore doli në përfundimin se 40% e të rinjve në Shqipëri kanë një dëshirë të fortë për t'u larguar jashtë vendit dhe pjesa dërrmuese e tyre u shprehën se nuk do të ktheheshin më kurrë. Ndërsa një 20% tjetër shprehën një dëshirë të moderuar për t'u larguar. Më shumë sesa gjysma e atyre që duan të largohen (56%) u shprehën se arsyeja kryesore ishte se kërkonin kushte më të mira jetese. 18% të tjerë thanë se kërkonin mundësi më të mira punësimi, ndërsa 17% ishin në kërkim të një arsimimi më të mirë. (WFD, 2019)

Pavarësisht hapjes domethënëse të vendeve të punës në periudhën midis viteve 2014 dhe 2019, cilësia e punëve mbetet e ulët. Në vitin 2018 ishin hapur vetëm 221.000 vende të reja pune kurse në vitin 2019 papunësia arriti të ulej në shifrën 11.4% kurse papunësia e të rinjve ra në 21.5%. (Banka Botërore, 2019)

Të rinjtë në Shqipëri përballen me mundësi të kufizuara punësimi për një punë të denjë; disa ndeshen me rrethanat politike, situatat shoqërore apo kushtet e jetesës që i detyrojnë të largohen nga vendi. Disa të tjerë emigrojnë për t'u bashkuar me familjet e tyre, për t'u martuar apo për të gjetur mundësi arsimimi në sektorin tretësor. Në të njëjtën kohë, të rinjtë janë në kërkim të punësimit në të gjithë sektorët dhe fushat e vendeve ku emigrojnë. Duke pasur parasysh se largimi i të gjithë këtyre njerëzve ndikon në një zvogëlim të konsumit

total dhe kërkesës agregate, e cila tek e fundit ndikon negativisht volumin e prodhimit dhe shërbimeve, e përmes shtimit të vlerës bruto që i shtohet GDP-së, kjo shkakton një ndikim të tërthortë të rrjedhës emigruese në veprimtarinë ekonomike.

Pasiguria në punë, arsimimi i varfër, varfëria, pamundësia për të përballuar jetesën dhe pasiguria rreth së ardhmes, janë arsye të mjaftueshme për të rinjtë që të largohen nga Shqipëria, gjë që shpesh ata i ndalon edhe nga iniciativa për të krijuar familje.

Një ndër problemet më të mëdha që hasin të rinjtë në vështirësitë e tyre për t'u strehuar është huaja bankare. Janë të shumtë të rinjtë e mirarsimuar, shumë prej të cilëve me punë të mirë paguara dhe perspektivë të sigurt, të cilët kanë qenë pronarë shtëpish, por që kanë mbetur jashtë tregut të hipotekave.

### **Të rinjtë dhe zhvillimi i turizmit**

Turizmi është një mjet për të nxitur ekonominë dhe rritjen shoqërore në Shqipëri, përmes kërkesës për zhvillim, duke minimizuar ndikimet shoqërore, kulturore dhe mjedisore. Gjendja e tij është më e mirë se ajo e sektorëve të tjerë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë: ai konsumohet në pikën e hyrjes; është një industri e ndryshme dhe e karakterizuar nga një fuqi intensive pune që ofron një gamë të gjerë mundësish punësimi; punëson më shumë gra dhe të rinj sesa të gjitha industritë e tjera dhe krijon mundësi për sipërmarrësit e vegjël. Ndërhyrjet e nevojshme për të zgjeruar ndikimin ekonomik të turizmit kërkojnë një fokusim në rritjen e kapaciteteve midis të rinjve dhe të rejave në mënyrë që të mundën të sigurojnë vende pune në sipërmarrjet e turizmit, të sigurojnë mallra dhe shërbime për turistët dhe sipërmarrjet e turizmit, ashtu si dhe të themelojnë sipërmarrje të vogla dhe të mëdha.

### **Shëndeti i të rinjve**

Shëndeti është i rëndësishëm për të rinjtë shqiptarë të cilët dëshirojnë të kenë një jetë të gjatë dhe të jetojnë në mënyrë të shëndetshme, të jenë të mbrojtur nga aksidentet dhe sëmundjet dhe të marrin një shërbim të denjë shëndetësor. Shëndeti është një pikë kyçe dhe një element vendimtar sa i përket cilësisë së jetës dhe një popullsi e shëndetshme është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e një vendi.

Në këtë fushë është e rëndësishme të përmendim se Ligji për Përkujdesjen e Fëmijës ashtu si dhe Ligji për Mbrojtjen e Shëndetit është i mirë sa i përket arritjes së të drejtave shëndetësore të të rinjve, por në Shqipëri zbatimi i tyre ka nevojë për disa përmirësime sa i përket dispozitave ligjore, duke qenë se shumë probleme



që ndodhin në sektorin shëndetësor shkaktohen nga reformat e shpejta por jo të mirë menduara, ashtu si dhe nga korrupsioni.

#### 4. Përfundime dhe rekomandime

Pas ndjekjes së një metodologjie të mirëpërgatitur, me teknika të kryqëzuara, ne kemi dalë në disa përfundime dhe rekomandime për FRPD-në për sa i përket përfshirjes së të rinjve në PD.

##### Përfundime

- FRPD funksionet e saj i rregullon dhe administron me zbatimin e statuteve apo rregulloreve të brendshme, të cilat sigurojnë një funksionim dhe mbarëvajtje të përshtatshme dhe efikase të forumit
- Statutet dhe rregulloret e PDSH-së përfshijnë role të veçanta, detyra dhe përgjegjësi për forumin e saj rinor, edhe pse disa nga këto funksione janë të kufizuara apo në disa raste janë të mbështetura në disa kuota apo përpjesëtime të caktuara. Një analizë e këtyre funksioneve na ka treguar se sa e përkushtuar është PDSH për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në strukturat e brendshme vendim-marrëse.
- Ne kemi vërejtur se pozicioni i forumit rinor bëhet më i dobët kur vjen rasti për përfshirjen e këtyre të rinjve në listat fituese të kandidatëve për deputetë, pozicione lidershipi në nivel lokal, apo ndarjen e burimeve financiare për të garantuar funksionimin e duhur të organizatës rinore politike.
- Roli dhe rëndësia e FRPD-së zvogëlohet kur vjen puna te dhënia e mundësisë së të rinjve në vendim-marrjeve brenda partisë, apo në një nivel lokal apo kombëtar. Numri i të rinjve në nivel përfaqësimi në legjislativ është ende i ulët, vetëm 9.1% (në parlament). Përfaqësimi në nivel lokal, po të kthehemi mbrapsht në zgjedhjet lokale të vitit 2015 shënoi një rritje domethënëse të të rinjve nën moshën 35 vjeçare si pjesëmarrës në Këshillat Bashkiake, nga 28 anëtarë në vitin 2011 në 30 në vitin 2015, edhe pse shifrat në rang kombëtar të të rinjve nën 35 vjeç që morën pjesë në Këshillat Bashkiakë u dyfishuan nga viti 2011 në 2015. Kësisoj, ata janë të privuar nga mundësia për të luajtur një rol aktiv në politikë dhe të ndikojnë në legjislacion, politikë dhe programet e reja, si lokale ashtu edhe kombëtare.
- Anëtarët e FRPD e pranojnë faktin se listat për zgjedhjet lokale dhe parlamentare konsultohen shume rrallë me forumet rinore, përmes një procesi jo transparent dhe gjithëpërfshirës. Paçka se duket se nuk është e qëllimshme, duke marrë në konsideratë faktin se FRPD është pjesë e vendim-marrjes (kryesi) në PDSH, kur këto çështje diskutohen mes anëtarëve të FRPD reagimi i tyre është negativ.
- Nuk është surprizë që FRPD nuk zotëron një përfaqësim të garantuar në Parlament dhe Këshillat Bashkiake. Nuk ka ndonjë referencë në statutin e PDSH-së që garanton një kuotë minimale të përfaqësimit të të rinjve në parlament, qeveri apo këshillat bashkiake. Vetëm hartimi i listave të

- kandidatëve është një proces që funksionon në bazë të statutit të PDSH-së, por gjithsesi nuk ka garanci.
- Anëtarët e FRPD-së janë të shqetësuar për sa i përket përfaqësimit në strukturat vendim-marrëse në zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme, sepse vetëm disa prej tyre zgjidhen realisht për të konkurruar, ndërsa të rinjtë që vijnë nga shoqëria civile apo bota akademike, që i bashkëngjiten partisë vetëm në zgjedhje, janë të shumtë dhe shpesh në krye të listave. Kjo ka shkaktuar keqkuptime dhe i ka demotivuar strukturat rinore, veçanërisht që prej zgjedhjeve të fundit të 2017-tës.
- FRPD ka zhvilluar shumë aktivitete politike – kryesisht mbi edukimin demokratik dhe politik të mbështetur nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare – dhe ka qenë aktive me pjesëmarrje të gjerë në shumë ngjarje dhe veprimtari politike të PDSH-së, por nuk ka pasur dhe ende nuk ka një debat të brendshëm dhe publik mbi rolin e saj, apo rreth marrëdhënieve respektive politike me PDSH, rreth platformës dhe ofertave politike për zgjidhje të problemeve të tyre.
- FRPD ka treguar se është e përkushtuar në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe vajzave, por në të njëjtën kohë, është kufizuar në pragun 10% të vajzave pjesëmarrëse në forumet lokale rinore.
- Mungesa e një buxheti të akorduar në mënyrë të posaçme e pengon nxitjen në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në procesin vendim-marrës brenda PDSH-së. Varësia financiare dhe pamjaftueshmëria e burimeve financiare ka pasur një ndikim negativ të papërshkrueshëm mbi FRPD-së.
- Anëtarët e FRPD-së thonë se ata hasin një problem të madh në të qenët të mirëpritur, të promovuar apo të kuptuar, veçanërisht në degët lokale nga disa anëtarë të vjetër të PDSH-së. Shpesh kjo pengon përparimin e tyre dhe e ngadalëson hyrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje në të gjitha nivelet.
- Anëtarët e FRPD janë të bindur se sugjerimet e dhëna ndaj PDSH-së veçanërisht për prioritetet rinore që ajo duhet të marrë në konsideratë në programin e saj, si për shembull, arsimimi, punësimi, emigrimi, përfshirja shoqërore dhe ndikimet e pandemisë COVID-19, të cilat sipas të rinjve janë shumë të rëndësishme dhe do ta pasurojnë programin e PDSH-së me energjinë e të rinjve.
- FRPD nuk ka bërë publike ndonjë dokument bazë të të dhënave të organizimit, përfshirë platformat, debatet, strukturat, tabelat organizative, degët përbërëse, pozicionet politike, financimet e madje edhe detajet e kontakteve.
- Pjesëmarrja në platformat ndërkombëtare është rruga që paraqet një mundësi që FRPD të zgjerojë rëndësinë e saj brenda dhe përtej BE-së. Përveç kësaj, pjesëmarrja në platforma të tilla e ndihmon atë të sigurojë mbështetje dhe asistencë teknike, për të rritur besueshmërinë e saj dhe për të shkëmbyer praktika mbi zhvillimet partiake dhe performancën elektorale.

## Rekomandimet

- Përfshirja e FRPD-së me anëtarë, elektorat dhe qytetarë për të mundësuar zgjidhje politike dhe ide që frymëzojnë qytetarët dhe brezat e rinj.
- FRPD duhet ta përforcojë profilin e saj dhe duhet ta përmirësojë përfaqësimin e saj elektoral, duke u shndërruar në një forcë shtytëse për PDSH-në.
- FRPD duhet të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe në formimin politik të anëtarëve të saj.
- PDSH duhet të mendojë seriozisht rreth identifikimit dhe përqaqimit të metodave të reja të financimit të forumit të saj rinor.
- FRPD duhet të zhvillojë programin dhe zgjedhjet politike në konsultim me të rinjtë e botës akademike, biznesit, grupet e interesit, bashkësitë, apo duke konsideruar ekspertiza e brendshme mes anetareve, dhe kjo mund të bëhet përmes rigjallërimit të strukturave të brendshme të tilla si departamentet, bordet e këshillimit në nivel degësh.
- FRPD duhet të fillojë të rezonojë gjithnjë e më shumë me të rinjtë e shoqërisë shqiptare.
- FRPD duhet të zhvillojë një pjesëmarrje në zgjedhjet e brendshme më transparente dhe më kuptimplote që inkurajon gratë, të rinjtë, minoritetet dhe grupet e tjera që të përparojnë drejt vendeve të rëndësishme dhe udhëheqëse.
- FRPD duhet të investojë më shumë në hartimin e strategjive afatgjata për të tërhequr votuesit e rinj dhe planveprimet për përdorimin e teknologjive të reja dhe qasjeve bashkëkohore për përfshirjen e qytetarëve të rinj në tërësinë e proceseve politike dhe jo vetëm gjatë zgjedhjeve.
- FRPD duhet t'i zgjerojë përpjekjet e saj aktuale për arritjen e barazisë gjinore në të gjitha veprimtaritë e saj, strukturat e brendshme dhe proceset politike, duke ua mundësuar atyre të ushtrojnë të drejtën e tyre politike e duke i furnizuar gratë me hapësira, burime, mundësi e duke i mbështetur ato në përparimin e karrierës politike, në një mënyrë aktive dhe të barabartë.
- FRPD duhet të vazhdojë të këshillohet ngushtësisht me partnerët e saj të ngushtë dhe në veçanti me Forumin Rinor të CDU-së dhe EPP-së.

## Lista e referencave dhe burimeve

INTER-PARLIAMENTARY UNION (IPU). (2014). *Youth participation in national parliaments*. Berlin: IPU.

Agnieszka Kazimierczuk and Hannah Itcovitz. (2020). *Never giving up: youth voices and participation in the time of COVID-19*.

Alliance of Liberals and Democrats for Europe. (2018). *Manifesto 2018. Freedom, opportunity, prosperity: the Liberal vision for the future of Europe*. Madrid: ALDE.

Ampe, E. (2012). *Youth and democracy: the changing face of youth political engagement*. Strasbourg: The Congress of Local and Regional Authorities.

Ardjan Hackaj and Neshat Zeneli. (2016). *Disconnected: YOUTH IN DISADVANTAGED AREAS*. Tirana: FES.

Bacalso, C. (2019). *The future of young people's political participation: questions, challenges, and opportunities*. Strasbourg: European Commission and the Council of Europe in the field of youth.

Carter, B. (2015, July 17). Development outcomes of the political and social inclusion of young people. *Governance-Social development- Humanitarian-Conflicts*.

CDU, J. (2019). *Für ein Deutschland in dem wir gut und gerne leben. Regierungsprogramm 2017-2021*. Berlin: CDU.

Council of Europe. (2018). *New and innovative forms of youth participation in decision-making processes*.

CRCA. (2018). *Te rinjte ne Shqiperi: Raporti dhe Indeksi i Vleresimit per vitet 2015-2017 i planit Kombetar te veprimit per rinine shqiptare (2015-2020)*. Tirana: CRCA.

CRCA. (2020). *Rinia ne Shqiperi 2020 : Raporti Kombetar*. Tirane: CRCA.

Emily Rainsford, UK Political Parties' youth factions. (2018, October). A glance at the future of political parties. *Parliamentary Affairs, Volume 71; Issues 4*, pp. 783-803.

European Peoples Party. (2019). *EPP Manifesto. "Let's open the next chapter for Europe together"*. Brussels.

FES. (2019). *Rinia Shqiptare 2018-2019*. Tirana: FES.

Forumi Rinor i Partise Demokratike te Shqiperise. (2016). *Statuti* . Tirane.

Garunja, E. (2018). The education system in Albanian among changes and reforms. *PRIZREN SOCIAL SCIENCE JOURNAL / Volume 2, Issue 2*;

IDM. (2020). *Opinion poll: Trust in Governance 2019*. Tirana: IDM.

Iir Gedeshi and Russell King. (2018). *Neë trends in potential migrational from Albania*. Tirana: CESS and FES.

INSTAT and UNFPA. (2015). *Te rinjte ne Shqiperi, sfidat ne kohet qe ndryshojne*. Tirana: INSTAT.

Institute for Democracy and Mediation. (2016). *Analize e angazhimit politic ne Shqipëri*. Tirane: IDM-NDI.

Jessika T. Feezell; Jessica L. Jones. (2017). Political disagreement and the political participation of youth: Comparing online and offline settings.

Kiilakoski, T. (2020). *Perspective on youth participation*. Brussels: European Commission and the Council of Europe in the field of Youth.

Konrad Adenauer Stiftung&Kongresi Rinor Kombetar. (2019). *Perfaqesimi dhe pjesemarrja e te rinjve ne zgjedhjet vendore*. Tirana: KAS.

Krasniqi, A. (2017). *Nje vit i brishte per demokracine ne partite politike. Raport vjetor 2016*. Tirane, Shqiperi: Fondacioni "Friefrich Ebert" Zyra e Tiranes.

Mary Ęard Loreto Foundation. (2019). *Raporti Hulumtues Analitik mbi Migracionin. Rasti i Shqiperise*. Tirana: GEER.

MJAFT Foundation; Ęorld Bank; Agenda Institute. (2008). *challenges facing Albanian Youth on the road toëards employment*. Tirana: MJAFT Foundation.

Nevila Xhindi and Blerjana Bino. (2019). *Democratic Party of Albania; 10 years from noë*. Tirana: WFD.

OECD. (2014). *Handbook on Promoting Ęomen's participation in political parties*. Ęarsaë: OECD ODIHR.

Partia Demokratike e Shqiperise. (2018). *Statuti 2018*. Tirane.

Partia Demokratike e Shqiperise. (2020). *Udhezim nr 60. Per miratimin e rregullave per realizimin e procedures se propozimit, konsultimit dhe perzgjedhjes se kandidaturave per perfaqesim politik te PD ne nivel qendror dhe lokal*. Tirane: PDSH.

PARTNERS ALBANIA FOR DEVELOPMENT AND CHANGE. (2018). *Youth political participation in Albania*. Tirana: Partners Albania.

Rayan Mc Veigh and Jennifer Barnett. (2009). *Democratizing our youth. Citizenship, Community and Governance*. Ontario, CA.

Shanto Iyengar and Simon Jackman. (2004). *Technology and Politics: Incentives for Youth Participation*. Standford: CIRCLE.

The Conservative and Unionist Party . (2019). *Get Brexit Done! Unleash Britain's potential. The Conservative and Unionist Party Manifesto 2019*. London.

WFD. (2019). *National Survey: Young people and politics in Albania*. Tirana: WFD Albania.

WFD. (2019). *Youth emigration is damaging Eastern Balkan economies*. WFD.

WFD and IDI. (2019). *Cost of youth migration*. FD.

World Bank. (2019). *Systematic country diagnostic. 2019 UPDATE, Report NO 147451-AL*. Washington DC: World Bank Group.



---

WESTMINSTER  
FOUNDATION FOR  
DEMOCRACY

---

# Western Balkans Democracy Initiative

Westminster Foundation  
for Democracy (WFD)

[www.wfd.org/wbdi](http://www.wfd.org/wbdi)

